

UDHËZIM
Nr. 3, datë 4.3.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E PROGRAMEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL QË
PËRFITOJNË NGA MBËSHTETJA FINANCIARE, PËR VITIN 2026**

Në mbështetje pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 15/2029, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 2, të kreut I, të vendimit nr. 646, datë 5.10.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private”

UDHËZOJ:

1. Përfitojnë nga mbështetja financiare për vitin 2026, programet e formimit profesional në fushat “Programim” dhe “Industria kulturore dhe kreative”.

2. Në fushën “Programim” përfshihen: kodimi, programimi kompjuterik, zhvillimi i aplikacioneve, robotika, elektronika, shkenca e të dhënave, siguria kibernetike, inteligjenca artificiale, testimi i *software*-ve, dizajni i *software*-ve, dizajni i faqeve *web*, dizajni i përvojës së përdoruesit, dizajni i ndërfaqes së përdoruesit, mësimi makinerik/automatik, realiteti i shtuar, realiteti virtual ose algoritmet kompjuterike apo fusha të tjera të ngjashme.

3. Në fushën “Industria kulturore dhe kreative” përfshihen: departamenti artistik, kamera/kinematografi, kostumet, ndriçimi dhe pajisjet teknike, teknik zëri dhe pas-produksioni, efektet vizuale dhe efektet speciale, produksion dhe regjizurë, rekvizitat dhe dekorimi i setit ose promovimi/publiciteti apo fusha të tjera të ngjashme.

4. Fondet për zbatimin e këtyre programeve për vitin 2026, mbulohen nga fondet e programit të nxitjes së punësimit.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij udhëzimi. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj